

## **Shtojca 10**

*[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

*[Data 14.09.2021]*

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]*

**FEDOS sh.p.k**

**Adresa: Njesia Administrative Nr.2,Rruga Manol Konomi,Ndertesa Nr.14,Hyrja 2,Apartamenti 2.**

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-03153-08-18-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

### **BLERJE ECHO GJINEKOLOGJIKE PER NEVOJA TE DSHS-KURBIN**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]* Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

#### **1.FEDOS sh.p.k**

**K01514009I**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera **3.050.000** (tre milion e pesedhjetë mijë) leke pa TVSH

*(me numra dhe fjalë)*

#### **2.BIOMETRIC ALBANIA sh.p.k**

**J61827062E**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera **0** (zero) leke

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

#### **1.BIOMETRIC ALBANIA sh.p.k**

**J61827062E**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 0 (zero) leke

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Ne zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Kriteret në DST ju si Operator Ekonomik keni mundësi dokumentacioni si më poshtë :

Shtojca 7

#### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

##### 1. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e

lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates për trejetim të materialeve/paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklarate që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi, është konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, në përputhje me objektin e prokurimit. Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë.

Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve(2018, 2019, 2020) të operatorit ekonomik pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20%

se vleres së përlogaritur të fondit limit te kontrates.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

2.3.4 Deklarate për përmbushjen e afatit të garancisë (2 vite garanci, duke përfshirë blerjen dhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale, si dhe të gjitha shërbimet periodike parandaluese që parashikon prodhuesi brenda periudhës së garancisë).

2.3.5 Vetëdeklarata: që pajisjet e ofruara janë të reja, të një prodhimi original.

2.3.6 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga firma prodhuese / MAH / ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, (ku të provohet / dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) për tregtimin e materialeve objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, dhe origjinal ose fotokopje e noterizuar.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë konformiteti, FDA ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalente, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre dhe standardeve të zbatueshme të IEC / ISO 60601, ose ekuivalente aprovuar (e perditesuar);. (Dorëzimi i Certifikatës së Konformitetit është i Detyrueshëm); origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Çertifikatat e mesiperme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2.3.8 Për të gjithë artikujt e ofertuar me shenjen sterisko (\*) teknr, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave, me datë \_\_.\_\_.2021 në orën 10:00. Dorëzimi I kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Juridike /Sektorit Prokurimeve, në DSHS- Kurbin, të mbyllura në një zarf /kufi jo transparente të vulosur me cilin të shenohet:

“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni I Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit «\_\_\_\_\_» dhe jo para datës \_\_.\_\_.2021, ora

10:00.

Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf / kuti.

Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson. Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe te identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s'kualifikohet.

2.3.9 Operatori Ekonomik Ofertues duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë te punesuar 2 (dy) inxhinierë / (inxhinier biomedical/elektronik/informatik /elektrik ose fusha te ngjashme) në stafin e vet të certifikuar /trajnuar per instalim dhe servis pajisjesh mjekesore, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.

2.3.11 Ne zbatim te njoftimit te perbashket te APP-se dhe Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve me nr 25366 prot date 30.12.2020, operatori do te paraqese :

-Kopje te Çertifikates Elektronike te Fiskalizimit, per tatimpaguesit qe perdorin Platformen Qendrore te Faturave.

- Kopje te Çertifikates Elektronike te Fiskalizimit dhe Kopje te Vlefshme te Kontrates se Lidhur me Shoqerine e Çertifikuar per zgjidhjen e softwe-ike ne perdorim ,per tatimpaguesit qe leshojne faturat nepermjet zgjidhjes softwer-ike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**FEDOS sh.p.k Adresa: Njesia Administrative Nr.2,Rruga Manol Konomi,Ndertesa Nr.14,Hyrja 2,Apartmenti 2 me NIPT K01514009I**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3.050.000** (tre milion e pesedhete mije) leke pa TVSH [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

Ankesa: Nuk ka.

[**Titullari i Autoritetit Kontraktor**]

**DREJTORI**

**ALTIN GJONAJ**

